



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIQI-OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE

Dalës-lizëna

Nr. 1-77
Br.

Data 17.05.2019
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt. 24.05.2019, (e premtë) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit financiar të Ekzekutivit Janar – Mars 2019
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Komunën e Obiliqit, Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2018
5. Kërkesa e MAPL-së, për rishqyrtimin e vendimeve të Kuvendit komunal
6. Shqyrtimi i kërkesës nga Drejtoria e bujqësisë dhe zhvillimit rural, për caktimin e vendgjahut
7. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit, DKA-së, për formimin e dy Komisioneve:
 - a) Komisioni për ndarjen e kompenzimit të aktiviteteve jashtëshkollore
 - b) Komisioni për Ankesa për ndarjen e kompenzimeve të aktiviteteve jashtëshkollore
8. Shqyrtimi i kërkesës së DSHMS-së për objektin AMF në Milloshevë
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme



Kryesuesi i Komitetit

Burim Gërguri



Dalës-Izlozua

Nr. 1-78
Br.

Data 17.05.2019
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.16.4.2019, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm janë këta anëtarë: Burim Gërguri, Florije Jashari, Linda Sadiku, Fatmir Bekteshi, Hysni Mjeku, Qëndresa Dubova, dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Naim Miftari, drejtor i DHSPE-së, Arben Berisha, drejtor i DPUKP-së, Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH, Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, përf. i IZHL-së, përf. i OSBE-së dhe përf. i USAID-it

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës, për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës
4. Formimi i Komisioneve, sipas vendimit të Qeverisë nr.07/96, të dt.02.4.2019 (Plotësimi dhe Ndryshimi i Komisioneve)
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Burim Gërguri – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës, i cekur më lartë.

1.Pika e parë e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Komitetit ishin të pranishëm.

2.Pika e dytë e rendit të ditës

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

3.Pika e tretë e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën e Kryetarit të Komunës, për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës. Ne jemi konsultuar me MAPL-në dhe me zyren ligjore sepse ndryshimi dhe plotësimi i Statutit duhet ti nënshtrohet të gjitha procedurave ligjore të debatit publik, duhet të formohet Komisioni dhe pas një ose dy muajve të aprovohen këto ndryshime.

Fatmir Bekteshi – Pyeti se kush e formon Komisionin.

Burim Gërguri - Përgjegjet se Komisionin e formon Kuvendi komunal në përbërje prej 3-5 anëtarëve, nga Kuvendi, zyra ligjore, Drejtoria e administratës, duke respektuar edhe kuotën gjinore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit Komunal për shqyrtim kërkesa nr.II-284, e dt.08.04/2019, e Kryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës:

- a) **Formimi i Komisionit komunal**
- b) **Dhënia në diskutim publik**

Pika e 4 e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqet vendimin e Qeverisë së Kosovës, nr.07/96, të dt.02.4.2019 për formimin e Komisioneve. Vendimi i dt.9.3.2016, është marrë pas kërkesës së Kryetarit të Komunës, që objekti i banesave Hade dhe Hade 1, ti kalon në administrim Komunal, për çështje të brendshme. Besoj se me këto banesa do të përmbyllet cikli i njerëzve që do të strehohen. Banesat janë me vendim dhe karakter social dhe çdo vit bëhet kontrata. Këto banesa nuk do të jepen në shfrytëzim afatgjatë, por vetëm në bazë të Udhëzimeve administrative dhe Ligjit për të drejtën banesore, për rastet sociale dhe 2 kategoritë e dalura nga lufta.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” dhe 1 votë “Abstenim” morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim formimi i Komisioneve, sipas vendimit të Qeverisë nr.07/96, të dt.02.4.2019.

Pika e 5 e rendit të ditës

Burim Gërguri – Ju njoftoj se neve, na kanë ardhë edhe 2 kërkesa, është raporti financiar 3 mujor dhe nisma e Kryetarit të Komunës, për bashkëpunim ndërkomunal. Komuna e Drenasit e ka nxjerrë një propozim vendim për bashkëpunim ndërkomunal me Komunën e Vushtrisë, Obiliqit dhe Skënderajit, që për grandet të cilat do të lëshohen të mund të aplikojnë Kryetarët e Komunave, si partnerë ndërkomunal.

Hysni Mjeku – E përgëzoj këtë iniciativë, është një iniciativë e mirëseardhur, por mos të mbetet vetëm e shkruar në letër. Uroj të ketë edhe marrëveshje tjera në të ardhmen, për bashkëpunim ndërkomunal dhe mua më brengosë fakti që mos të mbetet vetëm e shkruar në letër, por të zbatohet. Mendoj se Komuna e Fushë Kosovës, po na mbetet çdoherë anash, ndërsa me pozicion me këtë Komunë, neve na lidhë më tepër.

Burim Gërguri – Sqaron se është viti i parë që ne po fillojmë me nismat ndërkomunale sepse kjo ide më parë nuk është promovuar nga MAPL-ja. Mirëpo, tash zyrtarisht obligohemi që memorandumet e Kryetarëve të Komunave, me i aprovue në Asamblenë komunale që me pasë efektin ligjor. Ne kemi pasë një bashkëpunim me Komunën e Fushë Kosovës, është ndërtuar një rrugë që e ka lidhë fshatin Dardhishtë me Prishtinën në vitin 2014-2015, nëse nuk gaboj vlera e mjeteve ka qenë mbi 500,000 €. Pra, Barileva dhe Breznica, është lidhë me rrugën e re, ndërsa pjesën tjetër e kemi pasur Mazgit-Bërnice, një rrugë e re me standarde. Bashkëpunimi ndërkomunal në atë kohë ka paraparë që obligimet e projektit ti merrë Komuna e Obiliqit, ndërsa pjesën e investimeve kapitale Komuna e Prishtinës.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe aprovim Nisma e Kryetarit të Komunës, për bashkëpunim ndërkomunal dhe në mbledhjen e radhës të Kuvendit të futet në rend dite.

Burim Gërguri – Tash, e kemi shqyrtimin e raportit financiar Janar-Mars, 2019 dhe për këtë çështje më detalisht do të na njoftoj drejtoresha e financave.

Zarife Behluli – Të hyrat vetanake për vitin 2019, janë 1 milion e 35,000 €, ndërsa realizim në periudhën janar-mars, janë 170,929 €. Alokim i mjeteve janë 5 milion e 809,204.79, shpenzim janë 1 milion e 164,442.44, të lira janë 3 milion e 409,392 €. Ju njoftoj se te shpenzimet kapitale janë të alokuara 3 milion e 671,956 €, të shpenzuara janë 113,958.92 dhe të lira janë 3 milion e 69 mijë e 121 €. Mbushja e projekteve nga të hyrat janë 49,268.98, te hartimi i projekteve dhe blerja e autoambullantave 30,000 €, ndërsa pjesa tjetër që ishte 170,000 është alokue në muajin prill.

Fatmir Bekteshi - Nëse, nuk bëhet vonë, le të jetë si rekomandim e dërgojmë në Kuvend, tash kërkesa nuk na ka ardhë dhe nëse, nuk bën ndryshime drejtoresha, ne e përkrahim.

Burim Gërguri - Është raport financiar që nuk votohet, por vetëm njoftohet Kuvendi dhe në planin e punës të Kryetarit, kjo është transparencë për investime kapitale, rrjedhjen e parasë publike dhe është obligim. Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit Komunal për shqyrtim kërkesa nr.IV-229, e dt.11.04.2019, Raporti financiar Janar-Mars 2019 dhe në mbledhjen e radhës të Kuvendit, të futet në rend dite.

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën e Labinot Rukollit dhe Rrustem Rukolli, nga fshati Rezallë, Komuna e Skënderajit për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore, ZK Milloshevë.

Kjo kërkesë, dërgohet për shqyrtim në Drejtorinë e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën nga Murtez Fejza dhe nga banorët e 2 hyrjeve të ndërtesës në rr.“Adem Jashari” për vendosjen e kulmit të ndërtesës për shkak të rrezikut nga reshjet atmosferike.

Arben Berisha - Në Obiliq, nuk ekziston një ndërmarrje si BVI-ja, që ishte më heret, por së pari ne duhet të shohim pronësinë e banesave aty dhe besoj se ajo ndërtesë është në rregullë me pronar. Besoj se Këshilli i drejtorëve, Kryetari dhe DSHPE-ja, mund të vendosin për këtë çështje.

Kjo kërkesë dërgohet për shqyrtim në DSHPE.

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën nga Hafiz Rusinovci, i cili kërkon zgjidhje për banim.

Naim Miftari – Propozon që kjo kërkesë ti dërgohet për shqyrtim DPUKP-së.

Kjo kërkesë i dërgohet për shqyrtim Ekzekutivit të Komunës.

Hysni Mjeku – I lus organet e administratës, jo çdo kërkesë duhet të dërgohet në Kuvend sepse së pari duhet të shqyrtohen në Ekzekutiv, në aspektin ligjor dhe profesional, pastaj na dërgohet neve si Komitet për me i rekomandue Kuvendit.

Burim Gërguri – Është vërejtje me vend sepse realisht Kuvendi nuk mund ti trajtoj të gjitha kërkesat e banorëve, por edhe është problem vëllimi i punëve, që duhet të kryhet.

Pika e 6 e rendit të ditës

Naim Miftari – Ju njoftoj se Kryetari i Komunës, ka formuar një Komision për hartimin e Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike në territorin e Komunës së Obiliqit dhe kërkoj që të rekomandohet për daljen në diskutim publik të Rregullores në fjalë. Ndërsa, në mbledhjen e ardhshme nëse, mbërrijmë ti kryejmë të gjitha procedurat administrative të jetë e gatshme për aprovim. Po ashtu, në bashkëpunim me BE-në, jemi në hartim të Planit komunal për eficiencë të energjisë elektrike në Komunën e Obiliqit dhe është një mundësi e mirë për investime nëse, aprovohet nga Kuvendi komunal. Edhe për planin duhet të ndiqen të gjitha procedurat njësoj sikurse për Rregulloren, dalja në diskutim publik dhe aprovimi në Kuvendin komunal. Pra, këto 2 çështje kërkoj të futen në rend dite në mbledhjen e Kuvendit komunal, në mënyrë që të dalin në diskutim publik.

Burim Gërguri – Meqë, paraprakisht nuk kemi material edhe s’mund të rekomandojmë asgjë.

Hysni Mjeku – Mendoj se në pikën të ndryshme të kaloj një Rregullore e rëndësisë së veçantë nuk bën.

Mbledhja përfundoi në ora 11:5’

Bashk.prof.për punë të KK-së


Azize Zeneli

